

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-09

Ankesë kundër AK: **KOMUNA E SUHAREKË**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Furnizim me material hidrosanitari -ndriqim-elektrik etj për Administrate ,QKMF dhe shkolla**

Nr.Prokurimit: **624-22-3122-1-1-1 & 624-022-050-111**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**N.T.P. "Air Tours" Rr. Hajdin Berisha, 23000, Suharekë**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Rr. Hajdin Berisha**

(Adresa)

**049426183**

(Kodi postar) **23000**

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

**Lulzim Gashi**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**Email: airtours 2017@outlook.com**

**17/11/2022**

(Data e parashtrimit të ankesës)

  
(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

-Data e njoftimit për kontratë është: 25.04.2022  
-Vendimi i AK: 27.09.2022  
-Qasja në dokumente të OE të rekoamnduar: 28.09.2022  
-Kërkesa e I-rë për RISHQYRTIM 29.09.2022  
-VENDIMI PËR APROVIM I AK në kërkesën për rishqyrtim 06.10.2022  
-Vendimi i AK për shpërblim të OE të njëjtë: 31.10.2022  
-Kërkesa për RISHQYRTIM e dates: 07.11.2022  
-Vendimi i refuzimit të kërkesës për rishqyrtim date: 09.11.2022

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtime të ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐

Jo ☐

-Na është dërguar përmes platformës së e-prokurimit

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

☒

Jo

☐

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**-Të bashkëngjitur keni:**

**-Vendimin e AK të datës 31.10.2022**

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

### -AK ka shkelur nenet:

Neni 1 Qëllimi

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 61 Tenderët Jo-normalisht të Ulët

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 3 Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

**\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

I.AK ka Rivlerësuar për të dytën radhë pasi që na ka aprovuar kërkesën për RISHQYRTIM (VENDIMI PËR APROVIM I AK në kërkesën për rishqyrtim 06.10.2022) për këtë procedurë duke e rekomanduar përsëri fitues Operatorin Ekonomik i cili nuk është i përgjegjshëm sepse ka ofruar kontrata dhe referenca në kundërshtim me ligjin dhe të cilat do të duhej të ishin subjekt i verifikimit dhe hetimit sepse janë kontrata dhe faktura fiktive dhe si të tilla AK është dashur që ti verifikojë e pastaj të marr masa ndaj OE të rekomanduar për ofrim të dëshmive të rreme e jo ta shpall fitues. Në bazë të qasjes që kemi patuar në ofertën e OE të rekomanduar në Listën e kontratave janë 3 kontrata me blerës privat, nga të cilat 2 prej tyre janë kontrata fiktive dhe AK është dashur të marr masa ndaj OE konform nenit 99 të LPP-së. Kërkesë e FDT-së ka qenë që nëse dëshmitë janë me blerës privat OE duhet ti dëshmojë me dëshmi nga banka, por OE vetëm njërin prej tyre e ka ofruar me dëshmi dy të tjerat nuk i ka ofruar me dëshmi sepse janë kontrata dhe dëshmi fiktive.

№	Lloji i Kontratës	№ prokurimit	Blerësi / Kontraktuesi	Data	Shuma
1	Furnizim me pajisje vegjetale	01/06/20	R.R.P. "NTT"	01.06.2020	17.730.00 €
2	Furnizim me material ndërtues, vegjetal për ndërtimin e	25/06/20	N.P.T. Bani	25.06.2020	8.891.19 €
3	Furnizim me pajisje vegjetale	20/06/20	HIG INVEST	20.06.2020	8.887.53 €
4	Furnizim dhe montazh i LED -efektoreve ndriçues të shtetit të sporteve	024-021-01-147	Komuna e Shkupit Shkollë "Abdyl Rrahaj"	29.07.2021 10.08.2021	960.00 €
5	Furnizim me aparatë vëzhgues	024-21-01-147	Komuna e Shkupit Shkollë "Zeta e Re"	05.05.2021 06.05.2021	294.00 €

Kontrate fiktive

Kontrate fiktive

## 2. Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

Edhe sikur OE të i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së, AK po ashtu ka bërë shkejlë të nenit Neni 61 Tenderët Jo-normalisht të Ulët.

Në këtë RIVLERËSIM II AK ka përdorur një diskriminim ndaj ne si OE, sepse në RIVLERËSIM II për ti ikur formulës për tenderët jo normalisht të ulët, ka marr parasysh faktin që të gjithë OE tjerë (përveq të propozuerit dhe ofertës sonë si ankues) nuk e kanë bërë zgjatjen e vlefshëmrisë së ofertës).

Por kjo nuk nënkupton që AK të vazhdojë të shpërblejë me kontratë OE i cili ka ofruar cmime jo normalisht të ulëta.

Sepse në Rregullar për tenderët Jo normalisht të ulët edhe në rastet kur nuk plotësohet kërkesa me tri kushtet për tenderët jo normalisht të ulët, AK bazuar në Rregullat për Tenderët Jo-normalisht të Ulët është dashur ta eliminojë OE të propozuar sepse ka ofruar cmimin JO NORMALISHTË TË ULËT.

### Neni 3

#### Informatat e përgjithshme

3.1 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të **gjitha kushtet e mëposhtme:**

- çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;**
- çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;**
- janë dorëzuar të paktën **3 (tre) tenderë.**

3.2 Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 3.1 të këtyre rregullave, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

Pra AK edhe pse nuk e ka marr parasysh faktin që OE i rekomanduar ka ofruar cmime JO NORMALISHTË TË ULËTA dhe i ka plotësuar 3 kushtet e nenit 3.1 të RRUOPP-së, konform nenit 3.2 të RRUOPP-së është dashur ta eliminojë këtë Oe për shkak se ka ofruar **cmime MANIPULATIVE dhe e ka rekomanduar si OE fitues:**

Poz		KOMENTI PER CMIM MANIPULATIV				cmime te maniluluar a
10	brave komplet per dyer pvc	cop	100	1.2 euro	<b>Brava komplet ndersa nje pozicion me poshte vetem doreza ka cmim astronomik!!! KY ESHTË CMIMI MANIPILATIV I OE TE REKOMANDUAR !!!</b>	
11	doreza per dyer pvc	cop	100	6 euro	Vetem dorza e braves per dyer PCV	
8	brave per dyer pvc	cop	100	6 euro	Vetem brava per dyer PVC	
16	cilinder per dyer pvc 9cm	cop	100	8 euro	Vetem cilindri per dyer PVC	

**TOTALI ME PJESE ESHTË: 6+6+8=20 EURO, ndersa ka ofruar komplet braven me 1.2 EURO!!!**

I	Material I bravarisë	KOMENTI
---	----------------------	---------

9	brave per dyer al	cop	150	0.20 euro	Cmimi jo normalishte I ulet
25	rrjet metali	meter	500	0.20 euro	Cmimi jo normalishte I ulet
31	brave me shipke al-180	cop	10	2.00 euro	Cmimi jo normalishte I ulet
45	varese per rroba	cop	200	0.10 euro	Cmimi jo normalishte I ulet
74	doreza per dyer te drurit	copë	100	0.25 euro	Cmimi jo normalishte I ulet

III	Material ujësellësit				KOMENTI
26	Rezervare 100 l	cop	15	12 euro	dmth rezervari me kapacitet 100 litra eshte me lire se sa rezerbari me kapacitet 50 lira, edhe pse cmimi per te dyjat eshte Jo normalishte I ulet (deshmi faturat e furnizimit)
27	Rezervare 50 l	cop	30	18 euro	
28	Guac per ec ulse	cop	20	5 euro	Cmim jo normalishte I ulet shiko deshmitet e furnizimit

Një situatë të tillë e parashohin edhe rregullat e reja në fuqi konform Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022 neni 41.3 dhe 41.4 të kësaj rregulloreje.

Për të gjitha shkeljet që janë bërë në këtë procedurë ne do të kërkojmë të drejtën tonë dhe do të informojmë të gjitha institucionet përkatës, për kontratat fiktive institucionet hetimore, për shkeljet për cmimi jo normalisht të ulët KRPP/OSHP dhe për dhenie të kontratë OE pa validitet (prej 30 ditësh të ofertës) KRPP-në e cila sigurisht se do të ndërmerr masa adekuate.

**KËRKOJME nga AK që të kthejë lëndën në RIVLERËSIM dhe:**

1.Të kërkojë nga OE të sjell dëshmitë për kontratat fiktive, natyrishtë se nuk do të mundë të sigurojë këto dëshmi sepse tashmë dihen se janë fiktive, të refuzojë ofertën e OE, të bëjë kërkesë në OSHP konform nenit 99 për OE e rekomanduar, dhe të na shpall ne fitues si OE i përgjegjshëm me cmimin më të lirë.

2.Të refuzojë ofertën e OE të rekomanduar si ofertë me cmime manipulative dhe si Ofertë që i ka plotësuar të tri kushtet për tenderët JO-normalisht të ulët siq është përcaktuar në Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët (pavarësisht se OE tjerë nuk ka ofruar zgjatje validiteti por ata janë vlerësuar si të përgjegjshëm nga ana e juaj).

Nëse AK nuk ndërmerr hapat e sipërsëhënuar përveq që do të ankimojmë lëndën në OSHP, do të kërkojmë hetim detal të të gjitha elementeve që kemi cekur më sipër sepse janë shkelje që vërehen edhe nga ata që nuk kanë kurrfar eksperience në këtë fushë.

**Pra AK nuk vlerësuar konform LPP-së dhe RRUOPP-së dhe rregullave për tenderët jo normalisht të ulët, andaj kërkojmë nga OSHP që të aprovojë ANKESËN tonë dhe lëndën ta kthejë në RIVLERËSIM dhe të këtë vlerësim konform kërkesave të FDT-së, ku në do të shpallëshim fitues të këtij projekti.**

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Ne si OE jemi të dëmtuar në këtë procedurë, sepse jemi OE i përgjegjshëm me cmimin më të lirë, nuk ju kemi ofruar cmime manipulative dhe jemi dëmtuar nga AK sepse i ka mundësuar OE të jenë konkurent me oferta manipulative dhe cmime të cilat nuk janë të zbatueshme.**

**Ne kemi angazhuar ekspert të fushave përkatëse, prokurim, juridik dhe ekonomik për të nxjerr të gjitha shkeljet e sipërsënuara dhe kjo na ka dëmtuar shumë në aspektin financiar.**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) *bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*